

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: __.__.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje Medikamente” për Qendren Socio-Shëndetësore Kamëz ndarë në lote:

Loti	Emertimi	Specifikime	Njesia
Loti 1	Prednisolon	25mg/2ml	ampulë
Loti 2	Tramadol hydrochloride	Solucion për injeksion x100mg/2ml-2ml	ampulë
Loti 3	Adrenaline	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 4	Atropine Sulphate	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 5	Hyoscine butylbromide	Solucion për injeksion 20mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 6	Diazepam	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë
Loti 7	Dexamethasone sodium phosphate	Solucion për injeksion 4mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 8	Diclofenac sodium	Solucion për injeksion 75mg/ 3ml	ampulë
Loti 9	Acetaminophen (Paracetamol)	500mg /tab	tabletë
Loti 10	Furosemide	Solucion për injeksion 20mg/2ml - 2ml	ampulë
Loti 11	Sodium Chloride	Solucion për infuzion 9g/1000ml - 500ml	flakon

Loti 12	Metoclopramide hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë
Loti 13	Morphine hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 14	Viper venom antiserum	Solucion për injeksion glass vial x 5ml	ampulë
Loti 15	Acetaminophen (Paracetamol)	100 mg /supost	Suppositories
Loti 16	Theophylline (as anhydrous) + Ethylenediamine	Solution for injection x (192mg + 48mg)/2ml	ampulë
Loti 17	Manitol	Solucion për infuzion 20g/1000 ml- 250ml	flakon
Loti 18	Phytomenadione (vitamina K)	Solucion për injeksion 1% - 1 ml	ampulë
Loti 19	Glucose	Solucion për infuzion 5% - 500ml	flakon
Loti 20	Haloperidol	Solucion për injeksion 5mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 21	Silver Suphadiazine	Krem 10mg/g - 50mg	Crem
Loti 22	Human tetanus immunoglobulin	Solucion për injeksion 250 IU/1ml	Box x 1 pre- filled syringe x 1 ml
Loti 23	Atenolol	100 mg/tab	tabletë

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

- 33600000-6 Produkte farmaceutike
- 33680000-0 Artikuj farmaceutikë

Vlera e fondit limit: 4,728,810 (katër milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) **Lekë pa TVSH**

Loti	Emertimi	Specifikime	Njesia	Fondi limit për secilin lot (Lekë pa TVSH)
Loti 1	Prednisolon	25mg/2ml	ampulë	1,086,000
Loti 2	Tramadol hydrochloride	Solucion për injeksion x100mg/2ml-2ml	ampulë	32,000
Loti 3	Adrenaline	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë	16,500
Loti 4	Atropine Sulphate	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë	2,550
Loti 5	Hyoscine butylbromide	Solucion për injeksion 20mg/ml - 1ml	ampulë	174,000
Loti 6	Diazepam	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë	119,000
Loti 7	Dexamethasone sodium phosphate	Solucion për injeksion 4mg/ml - 1ml	ampulë	196,000
Loti 8	Diclofenac sodium	Solucion për injeksion 75mg/ 3ml	ampulë	125,000
Loti 9	Acetaminophen (Paracetamol)	500mg /tab	tabletë	4,000
Loti 10	Furosemide	Solucion për injeksion 20mg/2ml - 2ml	ampulë	156,000
Loti 11	Sodium Chloride	Solucion për infuzion 9g/1000ml - 500ml	flakon	2,360,000
Loti 12	Metoclopramide hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë	90,000
Loti 13	Morphine hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/ml - 1ml	ampulë	3,588
Loti 14	Viper venom antiserum	Solucion për injeksion glass vial x 5ml	ampulë	70,852
Loti	Acetaminophen	100 mg /supost	Suppositories	15,000

15	(Paracetamol)			
Loti 16	Theophylline (as anhydrous) + Ethylenediamine	Solution for injection x (192mg + 48mg)/2ml	ampulë	4,500
Loti 17	Manitol	Solucion për infuzion 20g/1000 ml-250ml	flakon	48,000
Loti 18	Phytomenadione (vitamina K)	Solucion për injeksion 1% - 1 ml	ampulë	42,600
Loti 19	Glucose	Solucion për infuzion 5% - 500ml	flakon	126,000
Loti 20	Haloperidol	Solucion për injeksion 5mg/ml - 1ml	ampulë	3,800
Loti 21	Silver Suphadiazine	Krem 10mg/g - 50mg	Crem	4,820
Loti 22	Human tetanus immunoglobulin	Solucion për injeksion 250 IU/1ml	Box x 1 pre-filled syringe x 1 ml	48,200
Loti 23	Atenolol	100 mg/tab	tabletë	400

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara** sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;
- Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit/vlera e pritshme e kontratave të lotit apo shumës së loteve për të cilat oferton. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/c e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit të kontratës, është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit apo shumatores së fondit limit të loteve për të cilat oferton**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga entë publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për tregëtim me shumicë të barnave të lëshuar nga QKL ose QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, neni 28 “Tregëtimi me shumicë të barnave” i cili parashikon që tregëtimi i barnave behet nga subjekte të licensuar:

” 1. Tregëtimi me shumicë të barnave kryhet nga importuesi, eksportuesi, shpërndarësi farmaceutik, që është person juridik ose fizik, tregtar, vendas ose i huaj, **i pajisur me licencën përkatëse për këtë veprimtari, sipas legjislacionit përkatës për licencimin**. 2. Tregtuesi farmaceutik me shumicë mund të tregtojë me shumicë edhe pajisjet mjekësore, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin përkatës për pajisjet mjekësore” si dhe

Ligjin nr 10081 date 23.02.2009 (i ndryshuar) “Per licensat, autorizimet dhe lejet ne RSH”.

(shënim - përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse të furnizimit, ose nëse është rasti të prodhimit të mallrave objekt prokurimi, që lidhet me objektin e kontratës së prokuruar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë barin (barnat) te cilin (et) oferton, origjinën (vendi i prodhimit) dhe kompaninë prodhuese MAH.

***Argumentimi:** Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtësin e autorizimit për tregëtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion ne perputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

4. Për barnat (e listës së DST) të cilat janë të autorizuar për tregëtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqiten:

- autorizimi për tregëtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë
/ose/
- dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregëtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
/ose/
- operatori ekonomik, duhet të deklarojë se ka të drejtë ta furnizojë këtë bar për autoritetin kontraktor përfitues.

***Argumentimi:** Ky kriter vendoset në përputhje me Nenin 11 të Ligjit Nr. 105/2014 “Per barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar, ku në pikën 1 të këtij neni citohet:*

“1. Barnat që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë për përdorim njerëzor duhet të jenë të pajisura me autorizim për tregëtim nga Agjencia.”

5. Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregëtim në Republikën e Shqipërisë (që nuk gjenden ne listën e barnave të regjistruar dhe nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregëtim nga Agjencia), operatori ekonomik ofretues duhet të paraqesë:

- a. autorizim për tregëtim dhe bari të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;
/ose/
- b. bari të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm nëse ka marrë autorizim për tregëtim dhe qarkullon në vendin e tij,
/ose/
- c. bari të jetë i pajisur me autorizim për tregëtim nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA), ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- d. Dhe Autorizim i lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregëtimit) ose prodhuesi, ose distributori i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre në vendin tonë. Në rastin e autorizimeve të lëshuara nga distributorët e autorizuar, duhet të

provohet me dokumente lidhja e tyre (distributorëve të autorizuar) me prodhuesin/MAH (mbajtësin e autorizimit të tregtimit).

Argumentim: Ky kriter vendoset në zbatim të Nenit 11, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, e cila, parashikon:

“2. Në raste nevojash të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor),

, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Gjithashtu, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve mbi sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e barnave, edhe në rastin e barnave të paautorizuara, janë aplikuar të njëjtat kërkesa mbi origjinën e tyre, sikurse për barnat e autorizuara për tregtim. Kjo, duke u bazuar në Nenin 12, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, e cila parashikon:

“2. Agjencia i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhënien e autorizimit të tregtimit për:

a) barnat e prodhuara në vendin tonë;

b) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim dhe që qarkullojnë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

b/1) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim lokal dhe që qarkullojnë në vend, duke përmbushur përcaktimet e shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni.”.

c) barnat e prodhuara në vendet e Ballkanit, vetëm kur kanë marrë autorizim për tregtim dhe qarkullojnë në vendin e tyre;

ç) barnat e pajisura me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.”

Në bazë të të dhënave të deklaruara, KVO është në gjendje të bëjë verifikimin e tyre.

Argumentimi për pikën d: Kriteri vendoset në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (aftësia teknike), si dhe pika 3 e nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me qëllim zotërimin e reputacionit dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës. Kërkesa dhe vecanerisht lidhja me distributorin për barnat e pa autorizuara për tregtim në RSH, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifkimeve teknike

Specifikimi i Materialeve:

Loti	Emertimi	Specifikime	Njesia
Loti 1	Prednisolon	25mg/2ml	ampulë
Loti 2	Tramadol hydrochloride	Solucion për injeksion x100mg/2ml- 2ml	ampulë
Loti 3	Adrenaline	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 4	Atropine Sulphate	Solucion për injeksion 1mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 5	Hyoscine butylbromide	Solucion për injeksion 20mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 6	Diazepam	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë
Loti 7	Dexamethasone sodium phosphate	Solucion për injeksion 4mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 8	Diclofenac sodium	Solucion për injeksion 75mg/ 3ml	ampulë
Loti 9	Acetaminophen (Paracetamol)	500mg /tab	tabletë
Loti 10	Furosemide	Solucion për injeksion 20mg/2ml - 2ml	ampulë
Loti 11	Sodium Chloride	Solucion për infuzion 9g/1000ml - 500ml	flakon
Loti 12	Metoclopramide hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/2ml - 2ml	ampulë
Loti 13	Morphine hydrochloride	Solucion për injeksion 10mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 14	Viper venom antiserum	Solucion për injeksion glass vial x 5ml	ampulë
Loti 15	Acetaminophen (Paracetamol)	100 mg /supost	Suppositories
Loti 16	Theophylline (as anhydrous) +	Solution for injection x (192mg + 48mg)/2ml	ampulë

	Ethylenediamine		
Loti 17	Manitol	Solucion për infuzion 20g/1000 ml-250ml	flakon
Loti 18	Phytomenadione (vitamina K)	Solucion për injeksion 1% - 1 ml	ampulë
Loti 19	Glucose	Solucion për infuzion 5% - 500ml	flakon
Loti 20	Haloperidol	Solucion për injeksion 5mg/ml - 1ml	ampulë
Loti 21	Silver Suphadiazine	Krem 10mg/g - 50mg	Crem
Loti 22	Human tetanus immunoglobulin	Solucion për injeksion 250 IU/1ml	Box x 1 pre-filled syringe x 1 ml
Loti 23	Atenolol	100 mg/tab	tabletë

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Afati i skadencës: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se 1 vit dhe për ato medikamente të vecanta 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.
- Formë – doza, njësia dhe volumi për secilin bar është përcaktuar në DST dhe është detyruese.
- Paketimi: Mbi çdo paketim duhet të jetë shënuar emri i barit, formë - doza, kodi i barit, përçindja dhe përmbajtja, data e prodhimit dhe e skadencës, nr. i serisë, si edhe përveç pullës së kontrollit të barnave të aplikuar në paketimin e jashtëm/kutinë e ambalazhit të tyre.

Argumentim: Sipas kërkesës së përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë Nr 287, datë 12.07.2011, Nr Prot 2542, datë 12.07.2011 “Për pajisjen me vulë të barnave që përdoren në institucionet shëndetësore publike”.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP:

“38/b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë” si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, “për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.”

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Grafiku/afati i lëvrimit është caktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.